

MODELI PËR DOKUMENTIN KONSULTATIV

“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të Planit të Veprimit 2024–2026”

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të Planit të Veprimit 2024–2026”.

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi:

- Objektivin kryesor strategjik i cili ka të bëjë me një qeverisje efektive për migracionit në Shqipëri, nëpërmjet adresimit dhe menaxhimit të problemeve dhe sfidave që dalin nga lëvizjet e migrantëve, me synim rritjen e ndikimit të migracionit në zhvillimin e vendit, në dobi të emigrantëve dhe shoqërisë shqiptare.
- Miratimi i kësaj Strategjie si pjesë e detyrimeve kombëtare dhe e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për të përfunduar me sukses negociatat për Kapitullin 24 (Drejtësia,) të Acquis të BE-së, e cila përcakton qeverisjen e migracionit si një çështje thelbësore.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektligjit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 1 muaj, nga data 6 nëntor 2023 deri më 6 dhjetor 2023.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>:
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinаторit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: Sara.Shameti@mb.gov.al

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail: Sara.Shameti@mb.gov.al

Znj. Iris Hodaj - Përgjegjëse, Drejtoria e Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin, e-mail: Iris.Hodaj@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

- Me Urdhërin e Kryeministrit nr. 9, datë 26.1.2023 u krijua Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të saj të Veprimit, i kryesuar nga Zëvendësministri i Brendshëm dhe që në përbërje kishte anëtarë, përfaqësues të: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Me Urdhërin e Ministrit të Brendshëm nr.33 datë 13.3.2023 “Për ngritjen e grupit të punës në Ministrinë e Brendshme për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe planit të saj të veprimit”, filluan përgatitjet.
- Takimi i parë i Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) u mbajt në datë 21 qershor 2023, në ambientet e Hotel Tirana Internacional. Në këtë takim morën pjesë edhe anëtarët e Grupit Drejtues për Migracionin (ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 35, datë 10.3.2021). Në takim u ftuan dhe morën pjesë edhe përfaqësues nga institucionet e tjera të përfshira dhe organizatat ndërkombëtare.
- Me qëllim vijimin e punës në përputhje me prioritet e përcaktuara Ministria e Brendshme me mbështetjen e IOM kanë organizuar disa workshop-e kombëtare, në datat 9, 10 dhe 19 maj 2023. Workshop-et informuese të datave 9 dhe 10 maj kanë qenë të lidhura me zbatimin e Paktit Global për Migracionin (GCM) dhe identifikimin e objektivave prioritarë të tij që do të përfshihen në dokumentin strategjik.
- Në datën 19 maj 2023, Ministria e Brendshme organizoi, me mbështetjen e IOM-it, një tjetër workshop “Për vlerësimin e situatës aktuale dhe prioritetëve kryesore në fushën e migracionit në Shqipëri, në funksion të hartimit të draftit të ri.
- Në datat 20-21 Shtator 2023, u zhvillua në Pogradec një workshop mbi hartimin e Strategjisë Kombëtare Për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2024-2030, ku ishin të ftuar, anëtarët e GNP-së, si dhe përfaqësues të të gjithë institucioneve të parashikuara si zbatuese kryesore dhe bashkëzbatuese të ndërhyrjeve konkrete. Workshopi u moderua dhe monitorua nga Sekretariati Teknik për Migracionin në MB, dhe ekspertët e IOM.
- Më datë 8 shtator 2023 është thirrur takim konsultativ me të gjithë aktorët ndërkombëtarë, DBE, IOM, UNHCR, FRONTEX, EUAA etj, për të prezantuar objektivat e Strategjisë dhe konsultimin apo kërkesat eventuale për mbështetje nga ana e partnerëve.

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektakti i propozuar ka për qëllim miratimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2024-2026, i cili është përgatitur në vijim të strategjisë kombëtare për migracionin 2019-2022, që përfundoi afatin e zbatimit në dhjetor 2022.

Vizioni për migracionin është që “Deri në vitin 2030, në frymën e proceseve globale të migracionit dhe integritetit të Shqipërisë në BE, të jepet një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit, në kuadrin e Shqipërisë”.

Në linjë me këtë vision, objektivi kryesor strategjik është “Qeverisja efektive e migracionit në Shqipëri, nëpërmjet adresimit dhe menaxhimit të problemeve dhe sfidave që dalin nga lëvizjet e migrantëve, me synim rritjen e ndikimit të migracionit në zhvillimin e vendit, në dobi të emigrantëve dhe shoqërisë shqiptare”.

Propozimet

Projektakti vjen si nevojë e vazhdimësisë së proceseve të nisura me strategjinë e mëparshme kombëtare për migracionin dhe përmirësimit të mëtejshëm të politikave të migracionit nëpërmjet plotësimit të mangësive të hasura në adresimin e suksesshëm të sfidave të migracionit gjatë këtyre viteve.

Miratimi i kësaj Strategjie vjen edhe si pjesë e detyrimeve kombëtare dhe e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për të përfunduar me sukses negociatat për Kapitullin 24 (Drejtësia,) të Acquis të BE-së, e cila përcakton qeverisjen e migracionit si një çështje thelbësore.

Një faktor kyç në qeverisjen e migracionit është përmirësimi i koordinimit ndërinstitutional dhe përcaktimi i qartë i roleve dhe i përgjegjësisë të institucioneve përgjegjëse për migracionin. Ndonëse tashmë janë krijuar mekanizma për koordinimin ndërinstitutional për qeverisjen e migracionit, përmirësimi i mëtejshëm i tyre, si dhe i produktit që ato do të nxjerrin mbetet një nga sfidat kryesore të zbatimit të këtij dokumenti, ku roli kryesor drejtues do të bjerë mbi Ministrinë e Brendshme, si institucioni lider për migracionin në vend.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektligjit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.

- Si mendoni se mund të ndikojë ky dokument strategjik në përmirësimin e shërbimeve për migrantët?

- A është gjithëpërfshirës ky dokument strategjik në drejtim të forcimit të bashkëpunimit midis institucioneve përgjegjëse për politikat e migracionit dhe grupeve të interesit?